



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT	
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE	
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION	
Dok. No.	20
Dok. Ser.	110/26
Nr. i. s.	02
Br. Str.	22.01.2026
Page	



Në mbështetje të Nenit 12 të Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit me datë 21.01.2025, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet trajtimi i informacionit anonim me Nr. Prot. 3272/25, i pranuar përmes administratës së Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit më datë 29.12.2025, i cili kishte për objekt shqyrtimin e praktikave të dëmshme në procedurat e prokurimit publik.
2. Në mungesë të kompetencës nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit për trajtimin e rastit si në pikën 1 të këtij Vendimi, rasti delegohet në kompetencë të mëtutjeshme tek Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP).
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të APK-së.

Arsyetim

Më datë 29.12.2025, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit përmes administratës së saj, ka pranuar një informacion anonim që përmbante pretendime lidhur me krijimin e praktikave të dëmshme në procedurat e prokurimit. Pretendimet e paraqitura në këtë informacion u adresuan në formë kërkesë drejtuar APK-së, me qëllim ndërmarrjen e veprimeve për sigurimin e transparencës dhe konkurrencës së lirë në prokurimet publike.

Në këtë kontekst, subjekti raportues ka kërkuar nga Agjencia që të kryejë një rishikim urgjent të praktikave të hartimit të FDT-ve, të vendosë standardizimin e detyrueshëm të kriterëve për tenderët ICT, të sigurojë zbatimin efektiv të parimit të proporcionalitetit dhe të pranimit të ekuivalencës, si dhe të rrisë mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë gjatë fazës së dizajnit të tenderëve.

Mandati i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit është i përcaktuar me Ligjin e Agjencisë Nr. 08/L-017, dhe në kuptim të dispozitave të këtij ligji kompetencat dhe përgjegjësitë e Agjencisë kufizohen me zbatimin e ligjeve si: Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave si dhe Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

Bazuar në fushëveprimin ligjor të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit dhe duke marrë parasysh natyrën e pretendimeve lidhur me krijimin e praktikave të dëmshme në procedurat e

prokurimit, dhe duke qenë se këto çështje nuk hyjnë në fushëveprimin ligjor të Agjencisë, Agjencia shpall veten jo kompetente për trajtimin e mëtutjeshëm të rastit.

Prandaj, si rrjedhojë për shkak të mungesës së kompetencës për trajtimin tutje të pretendimeve të adresuara, Agjencia delegon rastin tek institucioni përkatës i theksuar si në pikën 2 të këtij vendimi.

Përndryshe, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit mbetet e përkushtuar që të ndërmarrë veprime në çdo rast kur ka të bëjë me mandatin ligjor dhe fushëveprimin e saj ligjor, për zhvillimin e procedurës së hetimit administrative brenda përgjegjësisë së saj në fushat si: konflikt interesi, deklaram i pasurisë apo dhuratave, si dhe sinjalizim.

Nga ajo çfarë u tha si në arsyetim, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi parashtruesi i kërkesës ka të drejtë ankese pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

**Ylli BULESHKAJ**
Drejtore i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit

Vendimi iu dërgohet:

- KRPP;
- Arkivit të APK-së;